# DËSHMI ARKIVI

**A-437248**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | I dashuri i vrau të bijën, flet nëna e vajzës shqiptare: Nuk shprehu asnjë emocion! Dënimi i pamjaftueshëm |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/i-dashuri-i-vrau-te-bijen-flet-nena-e-vajzes-shqiptare-nuk-shprehu-as-i103697` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 16:39:58 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 16:25:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3c78e3572e8298f33e8b1fe8e74bb27c733ecdbf62f16e4a5b964fa66ba14421` |
| TEKSTI | `3932697ef8d1b4171a8a600deee6affe267cedc2fadffe5c6a186ca28350b845` |
| PAMJA | `7e921ec2c288759fae80953a3b3d016cdfd2b699727ef5c118a67652f6db87a1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f76882e8d799c1930b026818bfd7a3e412388f41eeae6d8d9cf5e9e347c9856a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `73e8c8924a957fd02429e48b81c3779edfac09a50a42fd731e64bb0d0f94a240` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f76882e8d799c1930b026818bfd7a3e412388f41eeae6d8d9cf5e9e347c9856a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# I dashuri i vrau të bijën, flet nëna e vajzës shqiptare: Nuk shprehu asnjë emocion! Dënimi i pamjaftueshëm

Piranjat Përditësimi i fundit 11 Shtator 2026, 18:25



“Nuk është një dënim i përshtatshëm, sepse nuk janë marrë parasysh shumë gjëra”.

Me një zë të vendosur, por të shënjuar nga dhimbja, Morena Corbellini, nëna e Aurora Tilas, 13-vjeçares që u hodh nga ballkoni më 25 tetor 2024 në Piacenza, reagoi në emisionin “Ore 11” lidhur me vendimin e Gjykatës së Apelit të Bolonjës për të ulur nga 17 në 15 vjet dënimin ndaj ish-të dashurit të saj, i cili ka pranuar autorësinë e krimit.

Corbellini renditi ato që, sipas saj, nuk janë marrë në konsideratë në mënyrë të duhur, duke nisur nga paramendimi, i cili, sipas saj, del qartë nga aktet e çështjes, deri te sjellja e të riut menjëherë pas krimit.

“Fillimisht e mohoi, më pas pranoi vrasjen pa treguar asnjë emocion”, theksoi ajo. “Ndërsa dje, çuditërisht, në sallën e gjyqit qau”.

Një detaj që nëna e viktimës e sheh si një kontradiktë dhe që shton hidhërimin e saj për faktin se nuk iu dha mundësia të dëshmonte gjatë procesit gjyqësor.

“Besoj se është thelbësore t’u jepet zë atyre që nuk kanë zë, viktimave që mbeten pas”, u shpreh ajo, duke kujtuar se prej vitesh familjet kërkojnë që palës civile t’i kushtohet më shumë vëmendje, pasi shpesh, sipas saj, “nuk merret në konsideratë dhe nuk mbrohet”.

Një mungesë që, sipas saj, ka dëmtuar thellësisht besimin e saj te sistemi i drejtësisë italiane. Kërkesa e saj përfundimtare iu drejtua drejtpërdrejt institucioneve: “I kërkoj qeverisë të ndryshojë ligjet dhe t’i bëjë ato më të ashpra”.

Corbellini ka frikë se dënime të tilla të reduktuara mund të përcjellin një mesazh të rrezikshëm. “Me dënime kaq të lehta, kush e di sa persona mund të ndihen të autorizuar të bëjnë atë që iu bë vajzës sime”, përfundoi ajo. /**PiranjatNews**/

## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 11 Shtator18:18

### [Vrasja e shqiptarit Hoti në Itali, hetimet çojnë drejt rrjeteve të drogës]

Hetimet për vrasjen e Ferdinant Hotit, 35 vjeç, shqiptarit me banim në Mirano, po përqendrohen në botën e trafikut të drog&...

AKTUALITET 11 Shtator18:11

### [Frika nga përmbytjet ngrenë në këmbë banorët e ish-Kënetës në Durrës: Po vijnë shirat, duam investime]

Banorët e Durrësit kanë organizuar një protestë mbrëmjen e së enjtes të mbështetur nga deputetët e PD-së ...

AKTUALITET 11 Shtator18:08

[E kërcënuan në sallën e gjyqit, e ëma e Santiago Malkos bën kallëzim në polici: Më dëmtuan varrin e djalit…]

Një hetim i hapur së fundi nga prokuroria e Tiranës, ka vënë në qëndër të vëmëndjes disa persona që ...

AKTUALITET 11 Shtator17:47

[Qeveria jep 90 mijë m2 me 1 euro për investimin strategjik në Gjirin e Lalëzit]

Vendimi parashikon "vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore nr.178/44, nr.152/43 dhe nr.182, në zonë...

AKTUALITET 11 Shtator17:38

[Hita me strukturat në Tiranë, Korçë e Dibër: Godisni grupet kriminale, drogën dhe personat me armë]

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skender Hita, në një takim me strukturat e Policisë në Korçë,...

AKTUALITET 11 Shtator17:27

[Plagosje në një pikë kolaudimi në Durrës, ja informacionet paraprake]

Një plagosje me mjete të ftohta dyshohet që është regjistruar mesditën e sotme të kolaudimi në Durrës. Ende nuk di...

AKTUALITET 11 Shtator16:23

[Administrativja zhbllokoi pagat e magjistratëve, Rama: Sikur të kishte të njëjtën urgjencë për qytetarët]

Reagimi i Ramës: Nëse Gjykata Administrative do të kishte një standard për çdo qytetar apo institucion në vështir&eum...

AKTUALITET 11 Shtator16:18

[Rregullorja e re e GJKKO-së përjashtoi njerëzit e medias nga gjyqet, gazetarët njoftojnë për PADI: Kushtetuesja të marrë në dorë situatën]

Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë ka njoftuar se të hënën do të depozitojë në Gjykatën Kushtetuese n...

AKTUALITET 11 Shtator16:08

[Detaje të reja nga sherri në Shkozet/ 25-vjeçari po priste në radhë te kolaudimi, autori e qëlloi me kaçavidë]

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mesditën e sotme në zonën e Shkozetit ku debati mes disa të rinjve ka agravuar deri në p&...

AKTUALITET 11 Shtator15:40

[Euro prek minimum të ri, thyen për herë të parë edhe pragun e 92 lekëve]

Kursi i këmbimit të Euros me Lekun ka zbritur sot për herë të parë poshtë kufirit të 92 lekëve, duke prekur nj&eu...

## ME TE VIZITUARAT

SHOWBIZ 10 Shtator

["Jam princesha jote e vogël, të dua"/ I dërgont...]

Një oficere burgu në Britani ka shmangur dënimin me burg pasi u përfshi në një lidhje tre-mujore me një të burgosur, t&e...

AKTUALITET 10 Shtator

[EMRI/ Vrau shqiptarin dhe e dogji brenda makinë...]

Përgjegjësia e Cristiano Mossalit për vrasjen e shqiptarit Nexhat Ramës konsiderohet e sigurt, ndërsa ajo që mbetet për t&rsq...

BOTA 10 Shtator

[VIDEO/ Nëna bisedon me shoqen, pak metra më tej...]

Ky është momenti tronditës kur një vogëlushe humb jetën pasi shtypet nga një makinë, ndërsa ajo po luante me motr&e...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik]

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video




**Reagon Cllevio!**






**Reagon Cllevio!**



**Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!**




**Deklarata e Gjestit!**






Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.